

KOMUNA E PRISHTINËS
DREJTORISË PËR URBANIZËM
PRISHTINË

-ANKESË NDAJ LËNDËS

ME NUMËR : 05-Nr-350/02- 41721/25, dt 25.03.2025

PARASHTRUES I PROJEKTIT: UNIPROJEKT SHPK

E nderuara Drejtori,

Po ju drejtohem me shpresën që do të keni mirëkuptim dhe do ta shqyrtoni me përpikëri shqetësimin tim dhe banorëve për-rreth.NJOFTIMI PUBLIK i shpallur keto ditë për ndërtimin e hapësirave banesore të kompanisë UNIPROJEKT shpk do të dëmtoj dhe, në një mënyrë, do të vështirësoj jetesën në këtë zonë.

-Unë jam pronar i hapësirës kadastrale 0133-13, ndërsa

-Valon Havolli është pronar i hapësirës kadastrale 01334-14. Truallin tim e kam blerë në vitin 2012 dhe në marrëveshje me Arben Tupallën(shitës,me kontratë të noterizuar, tash në cilësi të bashkinvestitorit) kemi arritur akordancë që rruga të jetë e gjerë 5 metra. Ai është konsultuar me axhën e tij, Zymerin,(poashtu bashkinvestitor) të cilët kanë pranuar që rruga të ketë shtrirje nga rruga kryesore deri në fund të arës.

Të dy palët janë dakorduar që nga 2.5 metra të ofrojnë për kompletimin e rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore(ujitdhe kanalizimit). Kjo ka qenë një marrëveshje verbale, duke besuar se rruga, uji, kanalizimi ishin të rëndësishme edhe për ta vetë, pasi që kishin në plan të vazhdonin me shitjen e trojeve. Gjithashtu, unë ju kam kërkuar që uji dhe kanalizimi të instalohen nëpër atë rrugë para se të filloja ndërtimin. Arbeni më ka kërkuar 3500€ për kompletimin e këtij projekti, shumë të cilën ia kam dhënë në tërësi. Aktualisht kanalizimi dhe uji janë të vendosur në këtë rrugë, që shtrihet nga fillimi deri në fund të arës.

Problemi është se palët kanë vendosur që këtë hapësirë t'ia ofrojnë kompanisë UNIPROJEKT sh.p.k për ndërtimin e hapësirave banesore. Kjo do të ishte në rregull, nëse palët do t'i përmbaheshin marrëveshjeve të cilat vetë i kanë shpallur si të tilla. Kjo po më dëmton, dhe me hapësirën e rrugës kompania në fjalë po manipulon, duke mos i marrë parasysh interesat e banorëve të zonës e posaqërisht ndaj meje, duke u ofruar shumë afër dhe duke krijuar vështërsi të jashtzakonshme jetese.

-Unë kërkoj që rruga të jetë e tillë siç është planifikuar nga vetë pronarët 5 m dhe nga ky pozicion të kemi qasje në rrugë.

- Nga këto pika të planifikohet largësia dhe lartësia e lejuar.

-Kanalizimi dhe uji, që shtrihen përmes kësaj rruge, të ruhen nga dëmtimet sepse është jetike dhe shfrytëzohen vetëm nga dy shtëpi,njëra e legalizuar e tjetra ende jo.

-Që drejtorati juaj ta planifikoj dhe lejoj një plan më kreativ, ku do të ruheshin interesat e përbashkëta të të gjitha palëve konform rregullave, e jo të ndërtohet vend e pa vend.

Unë kërkoj të drejtën time, dhe ju ftoj që të dilni në teren, për ta shqyrtuar nga afër këtë hapësirë dhe shqetësimet e tona.

Çdo vendim jashtë kësaj, më detyron që të drejtën time ta kërkoj në Gjykatën kompetente.

Për të shmangur këtë hap, kërkoj nga ju që, në mënyrë të rregullt dhe ligjore, të mos e dëmtoni pjesën time dhe të ardhmen tonë.

Me respekt,
Mexhid Havolli
23.05.2025
Prishtinë